

Kalimi në shkollën primare

Letër për prindërit

Të nderuar prindër

Fëmija juaj mund të kalojë në shkollën primare në gushtin e ardhshëm. Ky kalim është një ngjarje e rëndësishme si për fëmijët, ashtu edhe për familjen. Shumica e fëmijëve e arrin këtë pa probleme.

Në bisedën tjetër me prindërit ju do të bisedoni me personin mësimdhënës për kopshtin e fëmijëve se si do të bëhet kalimi në shkollën primare. Personi mësimdhënës e ka njohur fëmijën tuaj gjatë dy viteve në situata nga më të ndryshmet.

Nëse ka dyshime për kalimin e rregullt në shkollën primare, mund të merren në konsideratë këto mundësi:

- Kalimi i vonuar në shkollën primare Këtë mundësi mund ta bisedoni së bashku me personin mësimdhënës për kopshtin e fëmijëve. Nëse ju dhe personi mësimdhënës e mbështetni këtë masë, drejtoria e shkollës mund të miratojë një vit tjetër në kopshtin e fëmijëve.
- Hyrja dyvjeçare në shkollë:
Hyrja dyvjeçare në shkollë është për fëmijë, të cilët janë vetëm pjesërisht të gatshëm për kalimin në shkollën primare dhe prandaj kanë nevojë për pak më shumë kohë për këtë kalim.
Hyrja dyvjeçare në shkollë bëhet, sipas rrethit shkollor, në mënyrë të integruar në një klasë të 1-rë ose në një klasë përgatitore. Në të dyja variantet lënda mësimore e klasës së 1-rë ndahet në dy vite. Pas dy vitesh fëmijët kalojnë në klasën e 2-të të shkollës primare.
Ndjekja e hyrjes dyvjeçare në shkollë numërohet si dy vite shkollore.

Bisedoni për pasiguritë gjithmonë së pari me personin mësimdhënës të kopshtit të fëmijëve. Nëse ekzistojnë dyshime në kalim dhe ka nevojë për një sqarim të gjendjes së zhvillimit, atëherë ju mund të zgjidhni, nëse ju dëshironi që një sqarim i tillë të bëhet tek mjekja juaj shkollore, tek mjeku juaj shkollor ose tek këshillimorja për edukim. Personi mësimdhënës e njuh procedurën e regjistrimit. Shërbimi i mjekësisë shkollore ju informon me kënaqësi, nëse ju keni pyetje të tjera.

Ekipi i mjekëve shkollore dhe mjekëve shkollorë